



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. Nr. 226/2020

Datë: 29 shtator 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe neni 16 paragrafi 2 dhe neni 21 paragrafi 2 i Rregullores Nr. 03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 239-të, të mbajtur me datë 29 shtator 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohen rekomandimet e Komisionit për Administrimin e Gjykatave, si në vijim:
 - Evitimi i shtyrjes së seancave gjyqësore në Gjykatat Themelore, si dhe
 - Caktimi i ekspertëve të gjeodezisë nga Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës.
- II. Pjesë e këtij vendimi janë rekomandimet e KAGJ-it.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 29 shtator 2020.



Skender ÇOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Komisionit për Administrimin e Gjykatave;
- Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe
- Arkivit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Rekomandimet e KAGJ-it të miratuara në takimin 239 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me evitimin e shtyrjes së seancave gjyqësore në Gjykatat Themelore, si dhe caktimin e ekspertëve të gjeodezisë nga Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës.

Çështja:

KAGJ rekomandon që KGJK të marr vendim për rekomandimet e propozuara si në vijim. Këto rekomandime do të ndihmojnë që të evitohet zvarritja e seancave dhe të garantohet rritja e efikasitetit të gjykatave.

Rekomandimet:

1. Përmirësimi i kushteve të punës për dorëzuesit e gjykatave, duke ju siguruar mjete të përshtatshme të qarkullimit, duke inkuadruar sistemin GPS në veturat të cilat përdoren nga ata, si dhe duke iu siguruar hartat e përditësuara me sistem të adresave nga komunat përkatëse, dorëzimi i ftesave të bëhet konform ligjit.
2. Duke ju referuar vendimit KGJK.nr.240/2019, i datës 12.12.2019, personeli i gjykatave sidomos ata që zbatojnë shqyrtimin e hershëm të lëndëve, të qasen në sistemin e Agjencisë së Regjistrimit Civil, për të verifikuar/siguruar adresat e palëve.
3. Në lëndet specifike, ku rrethanat objektive lejojnë, rekomandohet që pas mbajtjes së seancës fillestare të aplikohet modeli i mbajtjes së seancave gjyqësore te njëpasnjëshme. Sipas kësaj procedure, seancat gjyqësore, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, do organizohen në vazhdimësi dhe që koordinimi me palet tjera për datën e fillimit të mbajtjes së tyre (*çdo dite deri në përfundimi*) duhet të bëhet menjëhere pas seancës fillestare.
4. Me qëllim të garantimit të prezencës së palëve pjesëmarrëse dhe ekonomizimin e procedurës gjyqësore, rekomandohet përdorimi i postës elektronike (email) për thirrjen e prokurorëve, avokatëve dhe institucionet shtetërore në seanca gjyqësore, në ato raste kur lejohet me dispozita ligjore. Dhënia e pëlqimit për të përdorur postën elektronike mund të merret nga palet në seancën e pare ose pas përfundimit të saj.
5. Në rast të mungesës së dëshmitareve të thirrur në mënyre të rregullt, gjyqtarët të përdorin mundësinë e shqiptimit të gjobës, siç parashihet me nenin 135 dhe nenin 309 të Kodit të Procedurës Penale dhe me nenin 292 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

6. Lidhur me mungesën e mbrojtësve, të cilët kërkojnë shtyerë e seancave gjyqësore për shkak të dy seancave në të njëjtën kohë, të mbahen takime me Kryetarin e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe degëve regjionale, për evitimin e këtyre problemeve.
7. Në rast të mungesës së prokurorëve për seancë, të njoftohet kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, bazuar në dispozitën e kodit të procedurës penale.
8. Koordinimi i udhëheqësve të departamenteve, lidhur me formimin e trupave gjyqësore për evitimin e mungesës së njërës anëtar të trupit gjyqësor, e që ka për pasojë mos mbajtjen e seancës.

Çështja:

KAGJ rekomandon që KGJK të marr vendim për rekomandimin e propozuara si në vijim. Për këtë rekomandim KAGJ konsideron se do të ndikoj në drejtësi cilësore për qytetarë dhe për institucione.

Rekomandimi:

1. Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës, me rastin e angazhimit të gjeodetëve nga lëmi i gjeodezisë, me theks të veçantë në kontestet pronësore, rekomandohet të angazhojnë kompani gjeodete apo gjeodet të licencuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.